REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne: Date / Dana: 05 / 09 / 2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 72 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj • Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 72**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR KËMBIMIN E PJESËT E NGASTRAVE KADASTRALE; 667-1 DHE 667-2 Z.K TALINOC I MUHAXHERËVE, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 286-0 Z.K. TALINOC I MUHAXHERËVE, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT**

**I**

**Me këtë vendim këmbehen ngastrat kadastrale:**

- **667-1 Z.K. Talinoc i Muhaxhereve me sipërfaqe prej 231 m², pronë e Besmir (Fatmir) Ibrahimi dhe 667-2 Zk. Talinoc i Muhaxherëve me sipërfaqe prej 225 m² pronë e Besmir (Fatmir) Ibrahimi. Me;**

- **Pjesën e ngastres kadastrale 286-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt.**

**II**

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 667-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve në pronësi të Besmir (Fatmir) Ibrahimi me sipërfaqe prej 231 m², parcela 667-2 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve me siperfaqe prej 225 m² pronë e Besmir (Fatmir) Ibrahimit, kurse pjesa e parceles 286 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve është në pronësi të komunës. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese · Izlazne · Date / Dana 05 / 09 / 2024
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 73 | Nr.Faqeve Br.Strana 2
Ferizaj · Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 73**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR KËMBIMIN E NGASTRËS KADASTRALE; 963-1 Z.K. TALINOC I MUHAXHERËVE, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 7-0 Z.K. MUHOC, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT

### I

Me këtë vendim këmbehet ngastrat kadastrale:
- **963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxhereve me sipërfaqe prej 2298 m², pronë e Nafije dhe Bahri Xhemajli, me**
- **Pjesën e ngastres kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc me sipërfaqe prej 5056 m², pronë e Komunës së Ferizajt.**

### II

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve në pronësi të Nafije dhe Bahri Xhemajli me siperfaqe prej 2298 m² Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, kurse parcela 7-0 Z.K. Muhoc është në pronësi të komunës me sipërfaqe prej 5056 m² . Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

### III

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për rregullimin e parcelave si dhe me ketë këmbim krijohen kushte më të lehta për qasje të parcelave me të cilat kufizohet.

### IV

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 01. Nr. 38, datë 30.05.2024, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc, pronë e komunës është vlerësuar 40,00€ për m², prona private - parcela kadastrale

**V**

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen në librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi

**VI**

Për këtë vendim do të kujdeset drejtoria për gjeodezi pronë dhe kadaster si dhe Kuvendi i Komunës Ferizaj.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 09 / 2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot 74 | Nr.Faqeve. Br.Strana 2



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 74**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR KËMBIMIN E PJESËS SE NGASTRAVE KADASTRALE; 3206-0 Z.K. Ferizaj, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 489-16 Z.K. Ferizaj, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT**

**I**

**Me këtë vendim këmbehen ngastrat kadastrale:**

**-3206-0 Z.K.Ferizaj me sipërfaqe prej 341 m², pronë e Kemajl (Zahir) Berisha, me**

- **Pjesen e ngastres kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 341 m², pronë e Komunës së Ferizajt.**

**II**

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 3206-0 Z.K. Ferizaj në pronësi të Kemajl (Zahir) Berisha me siperfaqe prej 341 m², kurse pjesa e parceles 489-16 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 341 m² është në pronësi të komunës. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

**III**

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për interes të përgjithshëm publik, me qellim të zgjërimit të brezit të rrugës "Driton Islami" dhe krijimi i shiritit për daljen nga "Stacioni i autobusëve" deri te rruga "Cen Dugolli".

**IV**

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të Kuvendit të komunës me Nr. 01. Nr. 39, të datës 30.05.2024, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e komunës që është vlerësuar 300€ për m$^2$, prona private - parcela kadastrale 3206-0 Z.K. Ferizaj është vlerësuar 300 € për m$^2$, andaj në bazë të vlerësimit këmbimi i paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij vendimi.

**V**

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

**VI**

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër si dhe Kuvendi i Komunës

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
ZYRA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Data / Datum: 05 / 09 / 2024
Nr. Urgv / Org. jed. 01 | Nr. Prot. / Br. Prot. 75 | Nr. Faqeve / Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

**01.Nr. 75**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**
**PËR KËMBIMIN E PJESËS SË NGASTRES KADASTRALE; 3621-14 Z.K JEZERC, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 3485-4 Z.K. JEZERC, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT**

**I**

Me këtë vendim bëhet këmbimi i ngastrave kadastrale:
- **3621-14 Z.K. Jezerc me sipërfaqe prej 518 m², pronë e Hajrush (Milaim) Beqiri, me**
- **Pjesen e ngastres kadastrale 3485-4 Z.K. Jezerc me sipërfaqe prej 334 m², pronë e Komunës së Ferizajt.**

**II**

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 3621-14 Z.K. Jezerc në pronësi të Hajrush (Milaim) Beqiri me siperfaqe prej 518 m² Z.K. kurse parcela 3485-4 Z.K. Jezerc është në pronësi të komunës me sipërfaqe prej 334 m². Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

**III**

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për interes të përgjithshëm publik, asfaltimin e rrugës "Selman Uka" në Fshatin Jezerc.

**IV**

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr.01.Nr.09, datë 31.01.2024, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 3485-4 Z.K. Jezerc, pronë e komunës, është vlerësuar 25,00€ për m$^2$, prona private - parcela kadastrale 3621-14 Z.K. Jezerc është vlerësuar 25.00€ për m$^2$., andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij Vendimi. Për çfardo vlerësimi shtesë pala nuk kërkon kompensim sipas deklaratës me numër 10.Nr. 463-215 të datës 19.08.2024,

**V**

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen në librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

**VI**

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadaster si dhe Kuvendi i Komunës

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese · Izlazne · Date / Dana: 05 / 06 / 2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 76 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj · Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 76**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR KËMBIMIN E PJESËS SË NGASTRES KADASTRALE; 532-5 Z.K TALINOC I JERLIVE, PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 690-5 Z.K. TALINOC I JERLIVE, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT

### I

Me këtë vendim bëhet këmbimi i ngastrave kadastrale:

- **532-5 Z.K. Talinoc i Jerlive me sipërfaqe prej 23 m², pronë e Reshat (Liman) Malsiu, me:**
- **Pjesen e ngastres kadastrale 690-5 Z.K. Talinoc i Jerlive me sipërfaqe prej XX m², pronë e Komunës së Ferizajt.**

### II

Pronat të cilat propozohen të këmbehen janë të regjistruara parcela 532-5 Z.K. Talinoc i Jerlive në pronësi të Reshat (Liman) Malsiu me siperfaqe prej 23 m² , kurse parcela 690-5 Z.K. Talinoc i Jerlive është në pronësi të komunës me sipërfaqe prej XX m². Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

### III

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për interes të përgjithshëm publik, Komuna e Ferizajt në këto parcela ka implementuar projektin e zgjerimit dhe asfaltimit të rrugës "Nora Kelmendi" në Ferizaj.

**IV**

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr.01.Nr. 26, datë 29.03.2024, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 690-5 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e komunës është vlerësuar 290.00€ për $m^2$, prona private - parcela kadastrale 532-5 Z.K. Talinoc i Jerlive është vlerësuar 160.00€ për $m^2$., andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij vendimi.

**V**

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen në librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

**VI**

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadaster si dhe Kuvendi i Komunës.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KUVENDI I KOMUNËS – FERIZAJ UROŠEVAC – REPUBLIKA KOSOVO – SKUPŠTINA OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Data / Dana: 05/09/2024
Nr.Orgv / Org.jed: 01 | Nr.Prot. / Br.Prot.: 77 | Nr.Faqeve / Br.Strana: 1
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 77**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të nenit 12 të ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, nenit 52 të Ligjit të përgjithshëm të procedurës së përgjithshme administrative dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt Nr.01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01.NR.79 I DATËS 25.05.2018

**I**

**SHFUQIZOHET:** Vendimi i Kuvendit të Komunës me Nr.01.nr.79 i datës 25.05.2018.

**II**

Arsyeja e shfuqizimit të këtij vendimi është pasi që Drejtoria e Urbanzimit dhe Mjedisit kishte vështirësi në zbatimin e Vendimit Nr.79 të datës 25.05.2018 në inkasimin e mjeteve financiare dhe në mënyrë që mos të krijohet obligime të reja financiare.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit si dhe Drejtoria e Ekonomiësë dhe Financave.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
ZYRA E DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse Izlazne Date / Dana. 05/09/2024
Nr.Org. Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 78 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 78**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të dispozitave nenit 12 te Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, pargrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE; 631-2 Z.K. TALINOVC I JERLIVE, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTËRS KADASTRALE 690-5 Z.K. TALINOVC I JERLIVE, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT

### I

Shpallen Interes i Përgjithshëm - Publik pjesa e ngastrës kadatsrale:

**- 631-2 Z.K. Talinovc i Jerlive, me sipërfaqe prej 58 m², pronë e Atixhe (Izet) Aziri.**

### II

Ngastrat kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të zgjerimit të rrugës “Driton Islami”.

### III

Pjesa e parcelës kadastrale 631-2 Z.K. Talinovc i Jerlive propozohet që të këmbehen me pjesen e ngastrës kadastrale 690-5 Z.K. Talinovc i Jerlive sepse Komuna e Ferizajt paraprakisht ka shpronësuar parcelat që preken nga projekti i rrugës “Driton Islami”, mirëpo parcela kadastrale 631-2 Z.K. Talinovc i Jerlive nuk është përfshi në shpronësim dhe Komuna e Ferizajt nuk ka të planifikuar buxhet për shpronësim për këtë projekt sepse është përfunduar.

### IV

Pronat të cilat shpallen interes i përgjithshëm – publik janë të regjistruara 631-2 Z.K. Talinovc i Jerlive në pronësi të Komunës së Ferizajt, parcelat kadastrale 690-5 Z.K. Talinovc i Jerlive, është e regjistruar në emër të 690-5 Z.K. Talinovc i Jerlive, në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

**V**

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lart nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

**VI**

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmëive.

**VII**

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

**VIII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese Izlazne: Date / Dana: 05/09/2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 79 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 79**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë te nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR MARRJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PRONËS

## I

Merret e drejta e shfrytëzimit të parcelës kadastrale me Nr. P-72217092-02094-0 me sipërfaqe 2769 $m^2$ dhe parcelës kadastrale P-72217092-02447-0 me sipërfaqe 471 $m^2$, Z.K. Ferizaj të destinuara për N.L.P. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. dhe të objekteve të ndërtuara në këto parcela, pronë e Komunës së Ferizajt të destinuara për N.L.P. "STACIONI i AUTOBUSËVE" SH.A.

## II

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit të Komunës së Ferizajt

## III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE
FERIZAJ UROŠEVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Data / Datum / Date / Dana: 05 / 09 / 2024
Nr.Urgj. / Org.jed. 01 | Nr.Prot. / Br.Prot. 80 | Nr.Faqeve. / Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 80**
**Data: 30.08.2024**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr: 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizjat 01.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2024-2026

**I**

Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me Nr:249/24 i datës 20.08.2024 për vënie në Diskutim Publik të Draft Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026.

**II**

Vëhet në diskutim publik Draft Planit i Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026.

**III**

Propozimet, sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqitën ditën e debatit publik, i cili do të caktohet në afatet e parapara ligjore si dhe njoftimi për diskutim publik do të paraqitet në veb faqen e komunës.

**IV**

Për këtë vendim do të kujdeset Kuvnedi i Komunës si dhe Kryetari i Komunës.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

______________________

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse Izlazne: Date / Dana. 05/09/2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 81 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 81**
**Data: 30.08.2024**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, të nenit 6, neni 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 5, neni 13, neni 24, neni 25 të Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE ME NR. 489-9 Z.K. FERIZAJ DHE OBJEKTIT PËRCJELLËS N.P.L.STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.

**I**

Me këtë vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë pjesa e ngastrës kadastrale me Nr. P-72217092-00489-9 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 10094, dhe objektit të ndërtuar në këtę ngastër pronë e Komunës së Ferizajt, subjektiti juridik N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A. me numër identifikues 811049685, me adresë në Ferizaj, Rr."Ahmet Kaçiku", Republika e Kosovës.

**II**

Ngastra kadastrale me objekte përcjellëse i ipet në shfrytëzim N.P.L. Stacioni i Autobusëve SH.A, me qëllim të shfrytëzimit për Stacion të Autobusëve dhe zyre.

**III**

Afati për dhënien në shfrytëzim i ngastrës kadastrale me objekt të përshkruara më lartë, është 50 vite.

**IV**

Ngastra kadastrale e përshkruar më lartë me objekt përcjellës ipen në shfrytëzim pa kompensim,

**V**

Pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës, Kuvendi e autorizon Kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën me subjektin juridik N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

**VI**

Obligohet Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në operatin kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore dhe nënshkrimit të kontratës.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalëse Izlazne. Date / Dana: 05.09.2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 82 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 82**
**Data: 30.08.2024**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), neni 4, 5, 6 pika 1.1, dhe nenit 14 pika 1 e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4, 5 pika 1.2, dhe neni 24 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të nenit 51 Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË NGASTRËS KADASTRALE 2094-0 DHE 2447-0 Z.K. FERIZAJ

### I

Me këtë vendim i ipet në shfrytëzim afatshkurtër parcela kadastrale P-72217092-02447-0 me sipërfaqe 471 $m^2$ dhe P-72217092-02094-0 me sipërafqe 2769 $m^2$, Z.K. Ferizaj me objekte përcjellëse, pronë e Komunës së Ferizajt subjektit juridik-kompanisë publike "Ambienti" SH.A., - Ferizaj.

### II

Ngastra kadastrale me objekte përcjellëse i ipet në shfrytëzim "Ambienti" SH.A., me qëllim të shfrytëzimit për zyre, park dhe një pjesë parking.

### III

Afati për dhënien në shfrytëzim i ngastrës kadastrale me objekt të përshkruara më lartë, është 5 vite, vendimi mund të shfuqizohet edhe para kalimit të përiudhës prej 5 viteve nëse Komunës së Ferizajt i duhet prona apo "Ambineti" SH.A., ndërton objektin për zyre.

### IV

Ngastra kadastrale e përshkruar më lartë me objekt përcjellës ipen në shfrytëzim pa kompensim.

### V

Pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës, Kuvendi e autorizon Kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën me subjektin juridik "Ambienti" SH.A.

**VI**

Obligohet Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në operatin kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore dhe nënshkrimit të kontratës.

**VII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dese Izlazne: Date / Dana: 05/09/2024
Nr.Orgv Org.jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 83 | Nr.Fqeve. Br.Strana. 4
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 83
Data: 30.08.2024

Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 5 nën paragrafi 1.2, nën paragrafi 1.2.1. dhe nenet 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 11, 15 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 të datës 23.08.2013 si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, nenit të Statutit të Komunës së Ferizajt 01Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIMI PËR HARTIMIN E

## Planit Zhvillimor Komunal

## I

## Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2025 - 2033 i Komunës së Ferizajt

## II
## Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor Komunal duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

## III
## Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1. i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Ferizajt, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur planin strategjik multi-sektorial, i cili përfshinë planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

## IV
## Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Ferizajt të përfshira janë:

| Shifra | Zona Kadastrale | Sipërfaqja |
|---|---|---|
| 72209002 | BABLAK | 3682415 |
| 72209079 | BABUSH I RI | 3981144 |
| 72217056 | BALÇAK | 6367581 |
| 72217006 | BIBAJ | 4513713 |
| 72217001 | BLAJ | 1921255 |
| 72217010 | BURRNIK | 5449304 |
| 72209088 | CERNILLË | 4519370 |
| 72217027 | DOGANAJ | 1422087 |
| 72217033 | DRAMJAK | 6312964 |
| 72217092 | FERIZAJ | 11788627 |
| 72217017 | GAQKË | 11383952 |
| 72217029 | GËRLICË E POSHTME | 2046521 |
| 72217024 | GREME | 15348885 |
| 72217047 | GURBARDH | 15896705 |
| 72217090 | KATUNDI I RI | 10872360 |
| 72217087 | KATUNDI I VVJETËR | 4453852 |
| 72217053 | KOSHARË | 6294988 |
| 72217051 | KOSINË | 7272403 |
| 72217044 | LIQENI | 51422273 |
| 72217057 | MANASTIRC | 2978619 |
| 72209056 | MIRASH | 10979085 |
| 72217058 | MIROSALË | 15500827 |
| 72217059 | MUHAXHER | 474958 |
| 72217061 | MUHOFC | 2236972 |
| 72217062 | NEKODIN | 3667580 |
| 72217022 | NERODIME E EPËRME | 11072730 |

| | | |
|---|---|---|
| 72217030 | NERODIME E POSHTME | 4962554 |
| 72217067 | PAPAZ | 2968481 |
| 72217068 | PLESHINË | 20534814 |
| 72217069 | POJATISHTË | 6000922 |
| 72217045 | PRELEZI I JERLIVE | 8391456 |
| 72209060 | PRELEZI I MUHAXHERËVE | 2585453 |
| 72217072 | RAHOVICË | 15896890 |
| 72217071 | RAKAJ | 3364897 |
| 72217076 | SAZLI | 3717497 |
| 72217081 | SLIVOVË | 5528729 |
| 72217084 | SOFTAJ | 2999485 |
| 72217082 | SOJEVË | 9316359 |
| 72209074 | SURQIN | 2161504 |
| 72217046 | TALINOFCI I JERLIVE | 3085041 |
| 72217060 | TALINOFCI I MUHAXHERËVE | 4210647 |
| 72217091 | TERRN | 4481327 |
| 72217011 | VAROSH | 7264542 |
| 72217039 | ZASKOK | 6623332 |
| 72217040 | ZLLATAR | 8717104 |

## V
## Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.

## VI
## Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Ferizajt, Drejtoria e Urbanizmit dhe e Mjedisit koordinon procesin e Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

## VII
## Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

**VIII**
**Konsultimet Publike**

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

**IX**
**Afati i vlefshmërisë**

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore tetë (8) vjeçare.

**X**
**Gjuha zyrtare**

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës së Ferizajt dhe së paku në tri (3) kopje të shtypura e të vulosura dhe tri (3) kopje digjitale të origjinalit.

**XI**
**Programi**

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 par. 1.3 të Ligjit 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.

**XII**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**